VENDIM
Nr. 194, datë 5.4.2023

PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 173, DATË 18.3.2022, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR DHËNIEN E MBROJTJES SË PËRKOHSHME SHTETASVE UKRAINAS, PERSONAVE PA SHTETËSI DHE PERSONAVE QË KANË FITUAR MBROJTJE NDËRKOMBËTARE NË UKRAINË, ME VENDQËNDRIM TË PËRKOHSHËM OSE TË PËRHERSHËM NË UKRAINË, DHE PËR KRIJIMIN E TASK-FORCËS PËR MENAXHIMIN E FLUKSIT TË KËRKUESVE TË MBROJTJES NDËRKOMBËTARE"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 82, të ligjit nr. 10/2021, "Për azilin në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Brendshëm dhe të ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 3, të vendimit nr. 173, datë 18.3.2022, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 3/1, me këtë përmbajtje:

"3/1. Me përfundimin e afatit, të përcaktuar në pikën 3 të këtij vendimi, për personat që ndodhen ende në territorin e Republikës së Shqipërisë, u shtyhet qëndrimi deri në datën 17.9.2023.".

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme, Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama